



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Shkurt 2022

Çështje në fokus

Problematika e Mbulimit të Kostove të Energjisë Elektrike për Shoqëritë UK

I. Të Përgjithshme

Në sektorin UK aktualisht nga 57 shoqëri UK, 48 prej tyre nuk arrijnë të mbulojnë kostot operim dhe mirëmbajtje (O&M). Kostot e energjisë elektrike në sektorin e UK zënë rreth 30% të totalit të kostove O&M. Shoqëritë që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M e sigurojnë mbijetesën financiare me anë të subvencioneve nga qeveria qendrore, dhe/ose duke mos paguar faturën e energjisë elektrike ndaj OSHEE-së. Kjo gjendje ka sjellë një borxh të akumuluar të sektorit ndaj OSHEE prej rreth 10.7 miliard lekë (rreth 89 milion euro), që së bashku me kamatëvonesat në vite arrin në rreth 19.5 miliard lekë (rreth 162 milion euro).

Referuar kësaj gjendje, ERRU me mbështetjen e OSHEE ka ndërmarrë një studim që analizon në detaje situatën, si dhe jep rekomandimet përkatëse për daljen e sektorit UK nga kjo gjendje. Studimi jep qasjen kryesore për vlerësimin e kësaj situatë si dhe disa rekomandime si bazë nisje për zgjidhjen e problemit. Analiza është fokusuar kryesisht për 6 shoqëri UK, shuma e borxheve të cilave përbën rreth 63% të borxhit total të sektorit UK ndaj OSHEE-së (shih tabelën Nr. 1). Kostot e energjisë për këto shoqëri variojnë nga 40 deri 60% të kostove O&M. Konkluzionet dhe rekomandimet nga analiza e këtyre 6 shoqërive kanë karakter përgjithësues për të gjithë sektorin. [lexo më shumë](#)

Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve



Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Webinar i MP Water Group: Si ta bëjmë direktivën për efikasitetin e energjisë Water-Smart?](#)

Online
8 Shkurt 2022

[Webinari i Inovacionit i EWA-së: Ripërdorimi higjienik dhe i sigurt i ujit të ndotur](#)

Online
8 Mars 2022

[Konferenca e 7-të e Profesionistëve të Rinj të Ujit BeNeLux 2022](#)

Delft, Hollandë
4-6 Pril 2022

[LET2022 - Konferenca e 17-të e IWA-së për teknologjitë e ujit të pijshëm dhe ujit të ndotur](#)

SHUKALB gati për të nisur kalendarin e tij të trajnimeve për vitin 2022




Viti i kaluar ishte një vit mjaft i suksesshëm për Programin e Trajnimit të SHUKALB. Jemi të lumtur të raportojmë se kemi ofruar me sukses 13 kurse trajnimi dhe 3 programe të zhvillimit të

kapaciteteve, duke tërhequr një audiencë prej rreth 250 pjesëmarrësish nga 30 shoqëri uj ujësjellës kanalizime në të gjithë Shqipërinë. Këto trajnime përfshinin kurset e veta të trajnimit të SHUKALB, si dhe produkte dhe programe për zhvillimin e kapaciteteve si pjesë e partneriteteve të SHUKALB me Partneritetin e Danubit (D-LeaP) dhe Rrjetin Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve (RCDN).

Në përgatitje për nisjen e Kalendarit të Trajnimit të këtij viti, dhe si një praktikë e rregullt, SHUKALB ka shpërndarë tashmë tek shoqëritë e ujësjellësit në Shqipëri një Anketim të Vlerësimit të Nevojave për Trajnim (TNA) të të gjitha shoqëritë UK në mënyrë që të mbledhë informacione e nevojshme për nevojat e tyre për trajnime për vitin 2022. [lexo më shumë](#)

SHUKALB organizon takimin me trajnerët e angazhuar në Programin e tij të Trajnimit dhe Zhvillimit të Kapaciteteve



Në 21 janar 2022, SHUKALB organizoi një takim virtual me pjesëmarrjen e trajnerëve që janë të angazhuar në Programin e SHUKALB të Trajnimit dhe Zhvillimit të Kapaciteteve. Takimi u zhvillua në kuadër të Projektit “Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (RCDN)”.

Objekti i përgjithshëm i takimit ishte të lehtësonte informimin, shkëmbimin mes trajnerëve për programet dhe aktivitetet e

Reno, Nevada, SHBA
27 Mars - 02 Prill 2022

[IFAT 2022 - Panairi tregtar kryesor në botë për ujë, kanalizime, menaxhimin e mbetjeve dhe lëndëve të para](#)

Mynih, Gjermani
30 Maj – 3 Qershor 2022

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës
Kanalizime e Shqipërisë

zhvillimit të kapaciteteve që SHUKALB organizon në nivel kombëtar.

Takimi u moderua nga Valbona Paja, Zëvendës Administratore, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër. [lexo më shumë](#)

Lajme nga anëtarët tanë

Dimër, ne nuk të frikësohemi – Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime në Shqipëri marrin masa për përballimin e situatës së ngricave



(SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Shqipëria përjetoi një mot të pazakontë gjatë muajit janar, ku temperaturat ranë me disa gradë nën zero, për të paktën katër ditë radhazi. Në veçanti zonat verilindore dhe juglindore të vendit, por edhe ultësira perëndimore pësuan ngrica. Megjithatë, kjo situatë e pazakontë nuk i ka zënë të papërgatitur shoqëritë ujësjiellës kanalizime. SHUKALB ka qenë në kontakt me shoqëritë anëtare të tij që janë prekur më tepër, si UK Korçë, UK Pogradec, UK Bulqizë, por dhe UK Tiranë dhe UK Vlorë, duke u informuar mbi situatën dhe masat e marra prej tyre.

Masa e parë e ndërmarrë nga të gjitha Shoqëritë ishte ndërgjegjësimi i konsumatorëve për situatën, duke i informuar

ata se si të sillen me ujëmatësit dhe tubacionet në stinën e dimrit. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu